



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.11/2024

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët, Franciska Zhitija Ymeri kryesuese, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruesi [REDACTED], votues nga Prishtina, të paraqitur kundër zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me procesin e votimit në qendrën 1925-SH.F.M.U "Ahmet Gashi" për shkak të procesit të ndarjes së votuesve brenda qendrave të votimit, gjegjësisht klasës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me 9 shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.10.2024, merr këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa Anr.11/2024 e datës 04.10.2024, e paraqitur nga [REDACTED] [REDACTED] votues nga Prishtina, paraqitur kundër zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me procesin e votimit në qendrën 1925-SH.F.M.U "Ahmet Gashi" për procesin e ndarjes së votuesve brenda qendrave të votimit, gjegjësisht klasës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 9 shkurt 2025.

A r s y e t i m

Më datë 04.10.2024, PZAP-i, ka pranuar një ankesë të paraqitur nga [REDACTED], votues nga Prishtina, kundër Zyrës për Shërbime të votuesve, e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për procesin e ndarjes së votuesve në vendvotime, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, në të cilën pretendon se deri në zgjedhjet e vitit 2021, familja [REDACTED] kanë votuar të gjithë në një vendvotim, në qendrën e votimit 1925 - SH.F.M.U. " Ahmet Gashi", në Prishtinë.

Mirëpo, që nga Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të mbajtura më 14 shkurt 2021, është bërë ndarja e tyre si familje, në vendvotime të ndryshme brenda të njëjtës qendër të votimit.

Po ashtu, parashtruesi i ankesës thekson se ka bërë kërkesë në Zyrën për Shërbime të Votuesve, në kuadër të KQZ-së, që të ju mundësohet votimi i përbashkët në të njëjtin vendvotim, sepse sipas tij i'u është bërë shkelje e të drejtës së tyre për të votuar, dhe se kjo gjë ju ka penguar si

familje prej 30 anëtarëve, që të ushtrojnë këtë të drejtë, dhe nëse kjo situatë nuk përmirësohet, ne si familje nuk do të dalim për të votuar.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ, sqaron se sipas Rregullës Zgjedhore 03/2024 dhe procedurave të brendshme të KQZ, caktimi i votuesve në vendvotime bëhet sipas renditjes alfabetike të mbiemrave. Fillimisht, votuesit ndahen në vendvotime në bazë të shkronjës së parë të mbiemrit, dhe në rast se kjo nuk është e mundur, ndarja bëhet sipas shkronjës së dytë ose të tretë, derisa të përfundojë me renditjen e plotë të mbiemrit. Nëse mbiemri është i njëjtë dhe ndarja është e pamundur, atëherë merret për bazë ndarja sipas renditjes alfabetike të shkronjës së parë të emrit. Maksimumi i votuesve të cilët do të caktohen në një vendvotim është 750 votues, përjashtimisht kur KQZ mund të autorizojë rritjen e numrit nëpër qendra të votimit. Sipas përgjigjes së KQZ-ës, të gjithë shtetasve me të drejtë vote u mundëson, të kenë qasje në informatat e tyre lidhur me qendrën e votimit (objektin) ku janë caktuar dhe mundësin për të ndërruar qendrën e votimit, në mënyrë që votuesi ditën e zgjedhjeve të votoj sa më afër vendbanimit ku jeton. Kërkesën për ndërrim të qendrës së votimit mund ta bëni deri me datën 26 dhjetor 2024 përmes sistemit elektronik apo në zyrat e KKZ. Ndarja e votuesve në vendvotime (klasa) për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me 9 shkurt 2025 do të bëhet pas pranimit të ekstraktit të tretë nga Regjistri Qendror Civil dhe bëhet publike në sistemin elektronik pas certifikimit të listës së votuesve, andaj kjo ndarje në vendvotime është proces që ndodh me datën 4 janar 2025, dhe rrjedhimisht votuesit mund të shikojnë ndër të tjera edhe ndarjen e votueseve në vendvotime.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës të parashtruar nga ankuesi dhe përgjigjes së dhënë nga KQZ, vlerëson se e njëjta është e palejuar.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 3, me të cilin është përcaktuar se *“PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.”* Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9, të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Paneli gjen se të gjithë shtetasve me të drejtë vote u mundësohet, të kenë qasje në informatat e tyre lidhur me qendrën e votimit (objektin) ku janë caktuar dhe mundësin e tyre për të ndërruar qendrën e votimit, në mënyrë që votuesi ditën e zgjedhjeve të votoj sa më afër vendbanimit ku jeton. Kërkesa për ndërrim të qendrës së votimit mund ta bëhet deri me datën 26 dhjetor 2024 përmes sistemit elektronik apo në zyrat e KKZ. Ndarja e votuesve në vendvotime (klasa) për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me 9 shkurt 2025 bëhet pas pranimit të ekstraktit të tretë nga Regjistri Qendror Civil dhe bëhet publike në sistemin elektronik pas certifikimit të listës së votuesve, andaj kjo ndarje në

vendvotime është proces që ndodh me datën 4 janar 2025, dhe rrjedhimisht votuesit mund të shikojnë ndër të tjera edhe ndarjen e votueseve në vendvotime.

Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen rastet e tilla për ndarjen e votuesve brenda qendrave të votimit, gjegjësisht klasës, andaj paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP.

Nga arsyet e paraqitura më lart, në pajtim me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 3 të Ligjit për

Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.11/2024, datë; 07.10.2024

Kryesuese e Panelit
Franciska Zhitija



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.